



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

---

Tiranë, 3 qershor 2004

**AKT- TRANSFERIMI**

Mbështetur në VKM nr. 173, datë 26.03.2004 dhe në vendimin e Gjykatës së Tiranës, nr. 26853/1, datë 01.06.2004, në emër të qeverisë shqiptare, i dorëzoj bashkisë Lushnje aktet e transferimit të aksioneve të "Ujësjetllës- Kanalizimeve", Sh.a Lushnje, deri tani pronë e shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, si më poshtë:

**KAPITAL THEMELTAR I SHOQËRISË 355.000.000 LEKË, I NDARË NË 355.000 AKSIONE, ME VLERË NOMINALE 1000 LEKË, I CILI ZOTËROHET 100% NGA BASHKIA LUSHNJE.**

**KRYEMINISTRI**

**FATOS NANO**





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE**

*Drejtoria Juridike*

*Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme*

**URDHER**

NR 166 DATE 1-6 2004

**PER**

**NDRYSHIME NE AKTET E THEMELIMIT TE SHOQERISE ANONIME "UJESJELLES-KANALIZIME " SH.A LUSHNJE.**

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, te nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore dhe V.K.M Nr.173 date 26.03.2004 "Per transferimin e pronave te paluajtshme shteterore te sistemit te ujesjelles-kanalizime ne pronesi te njesive te qeverisjes vendore", me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

**URDHEROJ :**

**1. Ndryshimin e aktit te themelimit te shoqerise anonime "Ujesjelles- Kanalizime " Sha Lushnje si me poshte:**

**1.1 Pika 4 riformulohet:**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 355.000.000 leke, i ndare ne 355.000 aksione me vlere nominale 1000 leke, i cili zoterohet 100 % nga Bashkia Lushnje.

**2. Ndryshimin e statutit te shoqerise anonime "Ujesjelles- Kanalizime " Sha Lushnje si me poshte:**

**2.1 Neni 4 riformulohet :**

**Aksioneret e shoqerise**

Zoterues 100% i kapitalit te shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a Lushnje (aksioner i vetem) eshte Bashkia Lushnje. Kjo e drejte i kalohet Bashkise Lushnje nga Ministria e Ekonomise me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 173, date 26.03.2004.

**2.2 Ne paragrafin e pare te Nenit 6 fjalet "Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit" zevendesohet me fjalet "Bashkia Lushnje".**

- 2.3 Ne paragrafin e nente te Nenit 9 fjalet “Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit” zevendesohet me fjalet “Bashkia Lushnje”.
- 2.4 Ne paragrafin e fundit te Nenit 17 fjalet “Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit” zevendesohet me fjalet “Bashkia Lushnje”.
- 2.5 Ne nenin 20 te statutit fjalet “Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit” zevendesohet me fjalet “Bashkia Lushnje”.
- 2.6 Ne paragrafin e fundit te nenit 21 fjalet “Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit” zevendesohet me fjalet “Bashkia Lushnje”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme dhe Drejtoria Juridike te kryeje procedurat e depozitimit ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 173, datë 26.3.2004

PËR

TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË  
SISTEMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË PRONËSI TË  
NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, pika 3.1, shkronjat "a" dhe "b", 72, pika 5.1, shkronjat "a" dhe "b", të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe të neneve 3, shkronja "e", 4, 6, shkronja "a", dhe 16, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2002, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, të ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1, 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen pronat e paluajtshme të sistemeve përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve, të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit dhe të koncesionit, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe njërive të qeverisjes vendore me donatorët e huaj dhe me shoqëritë kontraktuese.
3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë prona sipas lidhjeve 1, 2 e 3 të këtij vendimi, janë të detyruara të ruajnë statusin juridik, si shoqëri anonime, të paktën për një periudhë 2-vjeçare.
4. Ministria e Ekonomisë të pasqyrojë ndryshimet e kapitaleve, që vijnë si rezultat i transferimit të pronave të paluajtshme në njësitë e qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 2 dhe 3. Forma e administrimit të sistemeve që transferohen të përcaktohet nga njësitë e qeverisjes vendore.
5. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore të kryejnë procedurat e regjistrimit të këtyre pronave.
6. Detyrimet financiare, të prapambetura deri në çastin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore, të rregullohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.
7. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, të transferojë në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, për vitin 2004 e në vazhdim, fondet përkatëse për pagat, sigurimet shoqërore, subvencionet e investimet buxhetore për pronat e transferuara, duke iu referuar buxheteve përkatëse të viteve të mëparshme dhe akteve ligjore në fuqi.
8. Ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore përkatëse të hartojnë udhëzimet e përbashkëta në zbatim të këtij vendimi.
9. Ngarkohen ministri i Ekonomisë, ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, ministri i Financave dhe ministri i Pushtetit Vendor dhe i

Decentralizimit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe donatorët e huaj, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

FATOS NANO

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR  
DHE I DECENTRALIZIMIT

BEN BLUSHI

MINISTRI I RREGULLIMIT  
TË TERRITORIT DHE I TURIZMIT

BASHKIM FINO

MINISTRI I EKONOMISË

ANASTAS ANGJELI

**Ndërmarrje të ujësjellësave dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen plotësisht**

Nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
				VKM Nr. Dt.	Lista Nr.
1	Ujësjellës Kanalizime Fush Krujë	Sh.a.	Bashkia Fush Krujë	366 05.06.2003	8
2	Ujësjellës Kanalizime Lushnjë	Sh.a.	Bashkia Lushnjë	366 05.06.2003	11
3	Ujësjellës Kanalizime Libohovë	Ndërm.	Bashkia Libohovë	643- 18.09.2003	16

T)

Ndërmarrje të ujësjellësave dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen plotësisht sipas sistemeve përbërës

Nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e QV në të cilat transferohen	Nr. e sistemeve që transferohen	Referenca e miratim. invent.
1	Ujësjellës Kanalizime Pukë	Sh.a.	Bashkia Pukë	Sist. 1	VKM 251 24.04.2003 Lista 11
2	Ujësjellës Kanalizime Delvinë	Sh.a.	Bashkia Delvinë	Sist. 4,5,6	VKM 366 05.06.2003 Lista 3
3	Ujësjellësi Shkodër Fshat	Ndërm.	Komuna Bushat Komuna Postribë	Sist. 1,4,7,11 Sist. 13,15,16,17	VKM 366 05.06.2003 Lista 4



**Ndërmarrje të ujësjellësave dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen vetëm për sistemet përbërës të identifikuar**

Nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e QV në të cilat transferohen	Nr. e sistemeve që transferohen	Referenca e miratim. invent.
1	Ujësjellësi Përmet	Sh.a.	Bashkia Këlcyrë	Sist. 2	VKM 251 24.04.2003 Lista 9
2	Ujësjellësi Elbasan Fshat	Sh.a.	Komuna Shushicë	Sist. 26,27	VKM 366 05.06.2003 Lista 5
3	Ujësjellës Kanalizime Eier	Sh.a.	Bashkia Roskovec Komuna Strum	Sist. 5 Sist. 6	VKM 643 18.09.2003 Lista 13

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI BASHKIAK LUSHNJE



VENDIM

NR 56 DATE 05.09.06

Keshilli Bashkiak Lushnje ne mbledhjen e tij te radhes te dates 05.09.2006  
pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetari I Bashkise z.Kadri Gega per  
disa ndryshime ne statutin e SHA Ujesjelles Kanalizime .

VENDOSI:

Te miratoi ndryshimet e paraqitura ne statutin e SHA Ujesjelles  
Kanalizimeve.

KRYETARI KESHILLIT BASHKIAK  
ABAZ DIKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LUSHNJE  
KRYETARI

Adresa: Lagja "Kongrasi" Lushnje

Tel. +355 35 221 39

E-mail: bashkia\_lushnje@yahoo.com

Lushnje, me 04.09, 2006

RELACION  
KESHILLIT BASHKIAK  
LUSHNJE

Te nderuar zoterinje keshilltar!

Me akt-trasferim date Tirane 03 Qershor 2004 Aksionet e SH.A " Ujesjelles Kanalizime" Lushnje kane kaluar ne pronesi te Bashkise Lushnje.

Si Kryetar I Bashkise per mbarevajtjen e SH.A " Ujesjelles Kanalizime" mendoj dhe kerkoj qe ju te vendosni:

1. Meqenese SH.A eshte me fleksibel ne perdorimin e fondeve dhe per realizimin e bashkepunimit me projektin KFW, " Ujesjelles Kanalizime" te mbetet SH.A

Me kalimin e pronesise se aksioneve nga Ministria e Ekonomise teresishte Bashkise Lushnje dhe qe kontrolli I aktivitetit te SH.A " Ujesjelles Kanalizime" te kontrollohet perjodikisht nga ekzekutivi I Bashkise, te behen keto ndryshime ne statutin e shoqerise.

Neni 4. " Transferimi I aksioneve ne rast privatizimi" te formulohet:  
"Transferimi I aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me propozim te ekzekutivit dhe vendim te Keshillit Bashkiak Lushnje, ne baze te legjislacionit ne fuqi"

Neni 6. "Keshilli Mbikqyres"

Pika 1 e ketij neni te formulohet:

"Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare, te cilet emerohen nga Keshilli Bashkiak Lushnje nga kandidaturat ( te pakten gjashte ) te propozuar nga Kryetari I Bashkise"

Neni 7: "Kryetari dhe N/Kryetari I Keshillit Mbikqyres"

Pika 2 e ketij neni te formulohet:

Keshilli Mbikqyres do te kete nje sekretar jashte anetareve te tij I cili emerohet nga Kryetari I Bashkise dhe I raporton atij per te gjitha vendimet e Keshillit Mbikqyres”

Neni 8. “Vendimet e Keshillit Mbikqyres”  
fund te ketij neni te shtohen dy paragrafe:

Paragrafi I pare:  
Vendimet e Keshillit Mbikqyres I dergohen nepermjet Sekretarit Kryetarit te Bashkise.

Paragrafi I dyte:  
Kryetari I Bashkise kur e cmon se Vendimet e Keshillit Mbikqyres bien ndesh me legjislacionin ose interesat e shoqerise, I referon Keshillit Bashkiak dhe kerkon prej tij shfuqizimin e ketyre vendimeve.

Neni 9. “Kompetencat e Keshillit Mbikqyres”  
Pika 7 e ketij neni te formulohet:  
“Keshilli Mbikqyres I propozon Bashkise Lushnje lidhur me keto ceshtje”

Neni 11. “Drejtoria”  
Pika 1 e ketij neni te formulohet:  
“Shoqeria administrohet nga Drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa antare. Numri I anetareve te Drejtorise caktohet me Vendim te Keshillit Bashkiak”

Pika 2 e ketij neni te formulohet:  
“Drejtoria emerohet nga Keshilli Mbikqyres nga kandidaturat e paraqitura nga Kryetari I Bashkise ( te pakten dy kandidatura per cdo antare Drejtorie) me 2/3 e votave te anetareve te Keshillit Mbikqyres”

Neni 12. “Kompetencat e Drejtorise”  
Pas pikes 5 te ketij neni te shtohet paragrafi I me poshtem: Kreditimet dhe Donacionet e dhena shoqerise te raportohen Bashkise Lushnje, e cila miraton marrjen e ketyre kreditimeve dhe donacioneve dhe marreveshjet perkatese ne baze te ligjeve ne fuqi.

Neni 17. “Rezultati I ushtrimit dhe percaktimi I fitimit”  
Paragrafi I fundit te formulohet:  
“Perdorimi I fitimit pas zbritjes se rezervses ligjore” propozohet nga Kryetari I Bashkise dhe vendoset nga Keshilli Bashkiak”

Neni 20. “Asambleja e pergjithshme”  
Ky nen te formulohet:  
“Te gjitha kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te parashikuara nga Ligji Nr. 7638 dt. 19.11.1992 “Per shoqerite tregetare” qe jane shprehur ne kete statut ushtrohen nga Bashkia Lushnje, me cilesin e aksionerit te vetem”  
2. Z. Malo Hizdri Kryetar I Keshillit Mbikqyres, si perfaqses I Ministrise se Ekonomise Publike ( ish aksionerja e SHA “Ujesjelles

Kanalizime” Lushnje) te zevendesohet me nje antare nga stafi ekzekutiv I Bashkise ose Sekretari I Pergjithshem I Ministrise Punve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit z.Gazmend Dibra.

3. Te emerohet ekspert kontabel Z. DASHHOR ÇARÇANI
4. Nje kopje e dokumentave te arshivuara nga SH.A”Ujesjelles Kanalizime” te dergohet ne arshiven e Bashkise. Cdo dokument dhe cdo korespondenc e Drejtorise dhe Keshillit Mbikqyres te SH.A “Ujesjelles Kanalizime” duke filluar nga data 01.08.2006 do te protokollohet ne sekretarin e Bashkise dhe nje kopje e tyre do te depozitohen ne arshiven e Bashkise.

**KRYETARI  
KADRI GEGA**

*Kadri Gega*

DIPERISE  
SH.A